



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2019

V E N D I M

Nr. 173, Datë 21/11/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 78, datë 08.07.2019, e z. D.E., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*aftësisë së kufizuar*” dhe “*përkatësisë në një grup të veçantë*” nga ana e I.E.V.P Vlorë dhe Komisioni i Masave Disiplinore, i ngritur pranë këtij institucioni.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas ankuesit.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur saj, rezulton se ndaj z. D.E., punonjës pranë I.E.V.P. Vlorë, me detyre kartelist, është filluar procedura për dhënie mase disiplinore, nga Komisioni Disiplinor i ngritur pranë këtij institucioni, në bazë të shkresës nr. 1055, datë 02.07.2019, me lëndë “*Konstatim shkelje për punonjës civil të I.E.V.P. Paraburgimi Vlorë D.E.*”, të eprorit të tij direkt, drejtuar Drejtorit të I.E.V.P. Vlorë. Ankuesi sqaron se motivacioni për fillimin e këtij procedimi konsiston në mos zbatimin e orarit zyrtar, si dhe mos respektimin e hierarkisë në institucion, duke dalë jashtë IEVP-së, pa leje të titullarit. Z. D.E. pretendon se ka marrë leje nga eprori i tij i drejtpërdrejtë, kur ka dalë jashtë institucionit për nevoja e tij, personale (ushqim, kafe, ujë), me kohëzgjatje të shkurtër dhe sikurse

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

ai edhe punonjës të tjerë dalin nga institucioni për përmbushjen e nevojave të tilla. Pavarësisht sa më sipër, procedimi disiplinor ka filluar vetëm ndaj z. D.E. dhe për asnjë punonjës tjetër të I.E.V.P. Vlorë. Ankuesi, i cili është ankuar edhe më herët pranë KMD-së, kundër I.E.V.P. Vlorë, pretendon se fillimi i procedimit për masë disiplinore është i qëllimtë dhe diskriminues ndaj tij, pasi ky procedim filloi menjëherë pas marrjes dijëni nga ky institucion, mbi Vendimin nr. 61, datë 13.05.2019, e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nëpërmjet së cilit është vendosur konstatimi i diskriminimit të ankuesit nga I.E.V.P. Vlorë dhe rikthimi i tij në pozicionin e financierit, nga e cila është larguar padrejtësisht.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 78, datë 08.07.2019, e z. D.E., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga nenin 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7², të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 1077/1, datë 11.07.2019, IEVP Vlorë dhe për dijëni ankuesit, ku kërkohet informacion, si më poshtë vijon:
 - 1.** Praktika e plotë mbi procedimin disiplinor të filluar ndaj ankuesit;
 - 2.** Akti administrativ, nëpërmjet së cilit, është dhënë masa disiplinore;
 - 3.** Të gjithat provat që disponon I.E.V.P. Vlorë, në bazë të së cilave është filluar procedimi disiplinor i z. D.E. dhe është dhënë masa disiplinore ndaj tij;
 - 4.** Informacion, nëse ankuesit i janë dhënë paraprakisht masa të tjera disiplinore.
 - 5.** Kontrata e punës së ankuesit/Urdhëri i emërimit në detyrë;
 - 6.** Kopje të vlerësimeve në punë përgjatë periudhës kohore, që ka punuar pranë I.E.V.P. Vlorë;

² Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

7. Informacion nëse, edhe ndaj punonjësve të tjerë të I.E.V.P. Vlorë, që kanë rezultuar me të njëjtën problematikë, sikurse z. D.E., është filluar procedimi disiplinor;

1. Në përgjigje të shkresës nr. 1077/1, datë 11.07.2019, së Komisionerit, I EVP Vlorë dërgoi shkresën nr. 1077/2, datë 16.08.2019, nëpërmjet së cilës informon se ankuesi D.E. punon në pozicionin e kartelistit në Sektorin Ligjor pranë I EVP Vlorë. Marrëdhëniet e punës ndërmjet palëve rregullohen me Kodin e Punës, ndërkohë që detyrat përkatëse dhe disiplina në punë e punonjësve parashikohet në aktet ligjore dhe nënligjore si: ligji nr. 8328, datë 16.04.1998 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”* (i ndryshuar), në VKM nr. 437, datë 20.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”*, Rregulloren e Brendshme të I EVP Vlorë, miratuar me Urdhërin nr. 5329, datë 07.06.2010, e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe urdhëra dhe udhëzime të ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Referuar shkresës së sipërpërmendur, Komisioneri informohet se Përgjegjësi i Sektorit Ligjor ka informuar Drejtorin e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë, nëpërmjet shkresës nr.1055 Prot., datë 02.07.2019, se punonjësi D.E. me detyrë kartelist, pranë Sektorit Ligjor, nuk ka zbatuar oraret gjatë punës, është larguar nga institucioni pa leje të eprorit, si dhe në datën 01.07.2019 është larguar nga detyra pa njoftuar, para orarit zyrtar 08:00 – 14:00. Në materialin bashkëlidhur shkresës së Përgjegjësit të Sektorit Ligjor janë reflektuar disa hyrje dhe dalje të punonjësit, të cilat pasqyrojnë faktin e lëvizjeve të tij jashtë institucionit.

Drejtori i I EVP-së, pasi është njohur me materialin e Përgjegjësit të Sektorit Ligjor, ia ka kaluar këtë material për kompetencë Komisionit Disiplinor, si dhe ka ngarkuar Sektorin e Burimeve Njerëzore, që ky material t’i komunikohet dhe punonjësit D.E.. Për sa më sipër, rezulton se punonjësi ka marrë dijëni dhe i është komunikuar njoftimi zyrtar për seancë dëgjimore para Komisionit Disiplinor.

Nëpërmjet Urdhërit nr. 1055/1, datë 02.07.2019, të Drejtorit të I EVP Vlorë është urdhëruar mbledhja e Komisionit Disiplinor në datën 03.07.2019. Në këtë takim është mbajtur Proçesverbali nr. 1064/1, datë 03.07.2019, ku rezulton të jetë pasqyruar fakti, si vijon: *“në këtë proçesverbal vetë punonjësi e pranon që ka dalë nga institucioni gjatë orarit të punës, por daljet i vlerëson të parëndësishme për kafe dhe nuk e di që të dalësh për kafe gjatë orarit të punës duhet marrë leje”*. Në përfundim të seancës, Komisioni Disiplinor i është drejtuar Drejtorit të institucionit me rekomandim për dhënien e masës disiplinore *“vërejtje me paralajmërim”*, si pasojë e mosrespektimit të orarit zyrtar dhe lëvizjeve të pajustificuara të punonjësit brenda orarit të punës.

Në cilësinë e drejtorit të institucionit, duke marrë parasysh praktikën disiplinore, rekomandimin e Komisionit Disiplinor në unanimitet, qendrimin që mban punonjësi, ku shprehet se: *“kam dalë nga*

institucioni gjatë orarit të punës, por daljet i vlerëson të parëndësishme për kafe, nuk kam shkuar larg apo afër dhe nuk e di që të dalësh për kafe gjatë orarit të punës duhet marrë leje”. Duke qenë se procedura disiplinore vlerësohet si e rregullt, ndaj punonjësit është zhvilluar një proces i rregullt administrativ, duke iu dhënë mundësia për t’u dëgjuar, shprehur, mbrojtur dhe për t’u njohur me të gjitha materialet në ngarkim të tij. Me Urdhërin nr. 1056/2, datë 03.07.2019, të Drejtorit të I EVP Vlorë është dhënë masa disiplinore “*vërejtje me paralajmërim*”.

Në shkresën e I EVP Vlorë theksohet fakti se ky institucion dhe Komisioni Disiplinor kanë vepruar në përputhje të plotë me aktet rregullative, që normojnë punën dhe disiplinën në punë të punonjësve, si dhe praktika disiplinore është zhvilluar në përputhje të plotë me Udhërin nr. 314, datë 13.01.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, “*Mbi procedurat disiplinore të punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe institucioneve të varësisë*”. Vendimmarrja e Komisionit Disiplinor në dhënien e masës disiplinore dhe llojit të saj ka qenë e kushtëzuar nga veprimet dhe mosveprimet e punonjësit D.E., që bien ndesh me disiplinën në punë, por edhe me qendrimin e punonjësit në komision.

Në lidhje me pretendimin se ky procedim ka filluar menjëherë pas marrjes dijeni nga institucioni të vendimit nr. 61, datë 13.05.2019, të KMD-së, I EVP Vlorë informon se sikurse ka njoftuar edhe më parë, në datën 29.05.2019, në takimin e realizuar me z. D.E., është diskutuar zbatueshmëria e vendimit të KMD-së. Në këtë takim, ankuesit i është bërë me dije fakti se pozicioni i specialistit të financës është i zënë. Një pozicion i tillë është i zënë edhe në institucionin më të afërt me I.E.V.P. Vlorë. Nga ana e z. D.E. është kërkuar që, në pamundësi të sistemimit të tij, në pozicionin e specialistit të financës, do të hiqte dorë nga një kërkim i tillë, nëse do të emërohej në një pozicion pune me klasë page të barabartë me specialistin e financës. Ndodhur në kushtet e përshkruara më lart, në pamundësitë aktuale të zbatimit të vendimit të KMD-së, në analogji me legjislacionin për shërbimin civil, në takimin e datës 29.05.2019, punonjësit D.E. i është komunikuar se është në listë pritjeje dhe në hapësirën e parë ligjore do të sistemohet në pozicion pune si specialist finance ose në një pozicion pune me klasë të njëjtë, sipas pëlqimit të tij. Gjithashtu, ky vendim është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Titullari i I.E.V.P. Vlorë e bën me dije KMD-në se referuar dosjes personale të z. D.E., rezulton se në momentin e procedimit disiplinor nuk ka patur pasa disiplinore në fuqi, por në periudha të mëparshme rezulton se është ndërshtuar me masa disiplinore, përkatësisht (1) në datën 05.09.2013 “*vërejtje me shkrim*” me motivacion “*mosrespektim orari zyrtar*” dhe (2) në datën 03.02.2017 “*vërejtje me shkrim*” me motivacionin “*moszbatim urdhëri të eprorëve*”.

Drejtoria e I.E.V.P. Vlorë thekson faktin se në zbatim të të gjithë akteve ligjore në fuqi, është e vendosur të reagojë ndaj çdo lloj shkeljeje të çdo punonjësi të saj. Në referencë të regjistrit të masave

disiplinore në IEVP Vlorë, për vitin 2019, rezulton se janë dhënë gjithësej 25 masa disiplinore, ku masa e ankuesit është me nr. rendor 19. Fakti që, ankuesi gëzon statusin e invalidit të pjessëshm, nuk përbën shkak për imunitet ndaj masave disiplinore apo justifikim për mosrespektim të rregullave apo detyrave të ngarkuara në mënyrë të ligjshme. Në shkresë theksohet fakti se ankuesi gëzon të gjitha të drejtat e garantuara me ligj, ashtu siç i kërkohet realizimi dhe respektimi i rregullave gjatë ushtrimit të detyrës.

Në shkresën e IRVP Vlorë theksohet fakti se ankuesi nuk ka ushtruar ankim administrativ ndaj masës disiplinore, sipas parashikimeve të Urdhërit nr. 314, datë 13.01.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, *“Mbi procedurat disiplinore të punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Institucioneve të Varësisë”*, fakt i cili tregon se ankuesi pretendon imunitet për shkak të statusit që gëzon.

- C. Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 08.10.2019, ora 12:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Seanca dëgjimore u zhvillua në mungesë të ankuesit D.E., i cili njoftoi paraprakisht për mospjesëmarrjen e tij në këtë seancë. Në seancë u paraqit përfaqësuesi i I.E.V.P. Vlorë, i cili depozitoi aktin Autorizim nr. 1200 Prot., datë 03.10.2019, të lëshuar nga Drejtori i I.E.V.P. Vlorë.

Përfaqësuesi me autorizim i I.E.V.P. Vlorë parashtroi prapësimet e institucionit që përfaqësonte duke theksuar faktin se masa disiplinore *“vërejtje me paralajmërim”* ndaj z. D.E., është dhënë si pasojë e largimeve të përsëritura të tij nga vendi i punës, pa lejen e përgjegjësit të zyrës. Hyrjet dhe daljet e ankuesit nga puna janë të reflektuara në procesverbal. Ai sqaroi se procedurat e ndjekura për dhënien e masës disiplinore janë korrekte dhe të mbështetura në ligj. Ai u shpreh se z. D.E. e ka kundërshtuar masën disiplinore të dhënë nga Drejtori i I.E.V.P. Vlorë, pranë Komisionit të Apelimit, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Gjatë seancës dëgjimore u sqarua se përfaqësuesi me autorizim i I.E.V.P. Vlorë, në këtë séance, ishte edhe eprori i drejtpërdrejtë i ankuesit, si dhe kryetar i Komisionit Disiplinor, që kishte dhënë masën disiplinore ndaj z. D.E.. I pyetur se sa punonjës kishte në varësi, përfaqësuesi i I.E.V.P. Vlorë u përgjigj se kishte në varësi kartelistin dhe sekretaren e institucionit.

I pyetur nëse masat disiplinore ndaj punonjësve dhe në rastin konkret ndaj ankuesit, duheshin dhënë në mënyrë të përshkallëzuar, përfaqësuesi i IEVP Vlorë u përgjigj se shkelja është gjykuar e rëndë nga Komisioni Disiplinor dhe është ky Komision që gjykon mbi masën e dhënë. Ai

theskoi faktin se pas dhënies së masës disiplinore, z. D.E. merr leje nga eprori i tij, kur largohet nga vendi i punës.

I pyetur mbi pasojat e ardhura nga shkeljet e konstatuara të z. D.E., përfaqësuesi i I.E.V.P. Vlorë u shpreh se shpeshherë zyra mbetet pa prezencë, pasi z. D.E. largohet pa dijeninë e eprorit të drejtpërdrejtë. Dosjet e ardhura mbeteshin tek zyra e informacionit, pasi mungonte punonjësi (z. D.E.) për t'i tërhequr.

1. Në vijim të seancës dëgjimore, kopje e procesverbalit të kësaj seance, iu dërgua zyrtarisht ankuesit, nëpërmjet shkresës nr.1594, datë 18.10.2019, së KMD-së.
2. Në vijim, z. D.E. dërgoi me e-mail kundërshtimet e tij, në lidhje me prapësimet e përfaqësuesit me autorizim të I.E.V.P. Vlorë, në seancë dëgjimore.
3. Me qëllim administrimin e mëtejshëm të informacionit mbi çështjen objekt ankese, Komisioneri iu drejtua zyrtarisht Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, nëpërmjet shkresës nr. 1077/4, datë 30.10.2019, ku kërkoi informacion mbi vendimmarrjen e këtij institucioni, mbi rastin e Z. D.E..
4. Në vijim, në datën 13.11.2019, ankuesi D.E. dërgoi me e-mail, pranë KMD-së, kërkesën për tërheqjen e ankesës së tij kundër I.E.V.P. Vlorë dhe Komisionit Disiplinor të këtij institucioni.

PËR KËTË ARSYE:

Mbështetur në nenin 94, pika 1, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 12-13 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Përfundimin e procedurës së shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 78, datë 08.07.2019, të z. D.E., pasi ky i fundit ka depozituar pranë KMD-së, kërkesë për tërheqje të ankesës.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – punesim
Shkak – aftesi e kufizuar